



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA




KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

- III - Nr. i prot. 184 Më Dt. 20-01-2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI VJETOR I PUNËS

JANAR-DHJETOR 2021



2021

DREJTORIA PËR ARSIM

Në këtë raport të Drejtorisë Komunale për Arsim janë paraqitur aktivitetet dhe punët që janë kryer përgjatë vitit 2021, të cilat janë zhvilluar sipas planifikimeve të bëra të planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë tërë vitit.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2021 ishin:

- Funksionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Përfundimi i investimeve të planifikuara në ndërtimin e çerdheve për fëmijë;
- Përfundimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018 dhe 2019;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike dhe teknologji informative;

Qëllime kryesore kishim:

- Ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor në shkollat e të gjitha niveleve;
- Përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të institucioneve edukativo arsimore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Funksionimin sa më të mirë të organeve drejtuese të shkollave;
- Ngritjen dhe zhvillimin profesional të kuadrit arsimor.

Objektivat tona të përhershme, që karakterizuan edhe këtë vit, janë:

- Përmirësimi i nivelit të mësimdhënies dhe të nxënësve në të gjitha shkollat;
- Zvogëlimi deri në minimum i mungesave të pa arsyeshme të nxënësve dhe mësimdhënësve;
- Ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe objekteve parashkollore (çerdheve);
- Riparimet e objekteve shkollore;
- Rregullimi i hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës;
- Zhvillimi i aktiviteteve të shumta jashtë kurrikulare në nivel shkolle dhe komune;
- Futja në procesin e implementimit të KB dhe KKK për të gjitha shkollat e komunës;
- Bashkëpunimi me komunitetin dhe me OJQ-të, aksionet vullnetare;
- Integrimi në procesin edukativo-arsimor i të gjithë fëmijëve të të gjitha komuniteteve pa dallim;

Edhe gjatë kësaj periudhe ishte prezente situata me përballjen me pandeminë Covid-19. Si rrjedhojë e kësaj gjendjeje, ne kemi bërë edhe punë të pa parashikuara në planin vjetor. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura në 4 etapa me nga 3 muaj, siç vijon:

Aktivitetet në periudhën janar – mars

Në fillim të muajit janar, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kemi dërguar kërkesat për furnizim me inventar për objektet e reja shkollore që janë në ndërtim e sipër. Jemi furnizuar me pako higjienike përmes Ministrisë së Arsimit dhe organizatës UNICEF dhe poashtu jemi furnizuar me 15 tabletë për fëmijët me nevoja të veçanta. Punët kanë rifilluar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), përkatësisht në riparimin e

dysHEMEVE në shkollën "Rudolf Ëalther" të Dejnës dhe ndërrimin e dyerve të klasave në shkollën "Katër Dëshmorët" në Ratkoc dhe në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë.

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimin në gjysmëvjetorin e dytë, kemi bërë pastrimin dhe dezinfektimin e shkollave dhe kemi planifikuar që Pakoja Pedagogjike për klasat 0 deri 5, të shpërndahet në të gjitha shkollat. Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave, përkatësisht në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë. Kemi mbajtur një takim në Kolegjiumin për Arsim në Prishtinë, në të cilin kemi hartuar planin e punës së kolegjiut për vitin 2021. Kemi bërë vizita në disa shkolla për të parë nga afër ecurinë e fillimit të mësimin në gjysmëvjetorin e dytë dhe kemi shpërndarë Paket Pedagogjike për klasat 0 deri 5 në të gjitha shkollat.

Në muajin shkurt është mbajtur një takim me drejtorët e shkollave dhe me përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të secilës shkollë, ku të pranishëm kanë qenë edhe pjesëtarët e stacionit policor në Rahovec. Në këtë takim kemi biseduar për sigurinë në shkolla dhe përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave shkollore të olimpiadës së matematikës dhe fizikës.

Nëpër shkolla ka filluar mbajtja e garave shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj do të jenë pjesë e garave komunale. Mbajtem një punëtori me Caritasin e Zvicrës për zbatimin e projektit të pajisjes me inventar të klasave parafillore.

Nëpër shkolla ka përfunduar mbajtja e garave shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj morën pjesë në garat komunale. U mbajtën Garat komunale të Olimpiadës së Matematikës, e poashtu edhe Garat Komunale e Fizikanëve të Rinjë. Procesi i garave shkoi mire dhe të njëjtën ditë i angazhuam komisionet vlerësuese për të vlerësuar punimet e nxënësve dhe për nxjerrjen e rezultateve në nivel komune.

Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), në fasadimin e jashtëm të objektit të ri të shkollës "Haki Stërmilli" në Retijë dhe punimet në objektin e ri të shkollës "Herogjntë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc.

Në muajin mars, punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1) në Guri të Kuq, Çifllak dhe në Drenoc, kanë vazhduar punimet në ndërtimin e çerdhes në Xërxë, ku u bë instalimi i rrjetit të rrymës elektrike e po ashtu edhe në çerdhen në Ratkoc. Punimet kanë vazhduar edhe në ndërtimin e shkollës në Retijë dhe Kaznik e poashtu edhe në Fortesë. Kemi nisur procedurën për realizimin e projektit "Furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra" dhe procedurën e projektit "Instalimi i kamerave në shkollat e komunës së Rahovecit.

Për nder të festës së 7 Marsit nderuam me mirënjohje të pensionuarit e vitit të fundit, veteranët e arsimit që kanë mbi 70 vjetë dhe familjarët e mësimdhënësve të ndjerë që humbën jetën gjatë periudhës së pandemisë. Në Ministrinë e Arsimit kemi dërguar specifikacionet për pajisjen me inventarë të 3 çerdheve të reja.

Edhe gjatë këtij muaji, punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave (Lot1 dhe Lot2) në Çifllak ku u punua në ndërtimin e aneksit të nyjeve sanitare të shkollës, në Drenoc ku ka përfunduar montimi i dyerve të klasave dhe do të vazhdohet me punët e dysHEMEVE të klasave.

Aktivitetet në periudhën prill – qershor

Në muajin prill, procesi mësimor u zhvillua normalisht, sipas skenarit A me prezencë në shkollë, mirëpo me vendim të Ministrisë së Arsimit procesi mësimor gjatë javës së parë dhe të dytë nuk u mbajt, për shkak të pushimit pranveror dhe për shkak të pandemisë. Punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave (Lot1 dhe Lot2) në disa pozicione, me ç'rast filluan punimet edhe në oborrin e shkollës në Malësi të Vogël. Në projektet kapitale kanë vazhduar punimet në çerdhen në Xërxë e po ashtu edhe në çerdhen në Ratkoc. Punimet kanë vazhduar në ndërtimin e shkollës në Retijë dhe Kaznik e poashtu edhe në Fortesë dhe në Hoçë të Vogël/Brestoc. Kemi grumbulluar specifikacionet nga të gjitha shkollat për të nisur procedurën e projektit “Pajisja e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike”. Kemi nisur procedurën e projektit “Pajisja e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike” Punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave (Lot1 dhe Lot2) në disa pozicione, si në Çifllak, ku është ndërtuar aneksi i njeve sanitare, në shkollën në Drenoc, ku ka përfunduar riparimi i dysHEMEVE të klasave. Punimet kanë filluar edhe në oborrin e shkollës në Nagavc, në Parkingun e oborrit të SHML “Xhelal Hajda-Toni”, e të tjera. Në projektet kapitale kanë vazhduar punimet në Retijë dhe Kaznik, Xërxë, në Fortesë, Krushë të Madhe dhe në Hoçë të Vogël/Brestoc. Gjatë fundjavëve u bë pastrimi i rregullt higjienik dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore. Kemi nisur procedurën për realizimin e projektit për ndërtimin e rrethojës së shkollës në Çifllak dhe projektin e furnizimit të shkollave me lëndë djegëse.

Komisioni për monitorimin e procesit mësimor nëpër shkolla, i emëruar nga DKA ka nisur punën dhe gjatë muajit maj ka vizituar disa shkolla. Ky proces vazhdoi edhe gjatë muajve në vazhdim. Kemi nisur procedurën për realizimin e projektit për furnizimin dhe pajisjen e çerdes së fëmijëve “Tulipanët” me roleta dhe tepihë. Janë bërë përgatitjet për mbajtjen e Testit të Arritshmërisë për klasat e 9-a, i cili u mbajt më 28.05.2021.

Në muajin qershor, procesi mësimor u zhvillua normalisht, me prezencë në shkollë sipas skenarit A, ndërkohë që më 3 qershor përfundoi gjysmëvjetori i dytë i mësimit për klasat e 12-a. Punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave në disa pozicione, si në oborrin e shkollës në Nagavc, në oborrin e shkollës në Dejnë ku kanë filluar punimet në ndërtimin e parkingut për nevojat e shkollës, e të tjera. Në projektet kapitale kanë vazhduar punimet në Retijë dhe Kaznik, Xërxë, në Fortesë, Krushë të Madhe dhe Ratkoc. Punimet kanë vazhdojnë edhe në ndërtimin e objektit të ri të shkollës “Tre Dëshmorët” në Vrajakë-Bratotin. Për nder të 1 Qershorit – Ditës Botërore të fëmijëve janë mbajtur disa aktivitete në bashkëpunim me DKRS. Komisioni për monitorimin e procesit mësimor nëpër shkolla, i emëruar nga DKA ka vazhduar punën dhe gjatë këtij muaji dhe ka vizituar disa shkolla.

Kemi patur një takim me komisionerët e angazhuar nga DKA për të administruar Testin e Maturës, i cili është caktuar të mbahet më 26 qershor 2021. Poashtu, takim kemi patur edhe në Ministrinë e Arsimit, ku u diskutua për organizimin e Testit të Maturës dhe për procesin e regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta.

Aktivitetet në periudhën korrik – shtator

U zhvillua procesi i regjistrimit të nxënësve në klasat e 10-ta, bazuar në konkursin e miratuar nga MASHTI. Në 6 shkolla të komunës sonë u bë furnizimi me inventar për 6 klasa parafillore, me të cilin u finalizua projekti “SHPREË”, i bashkëfinancuar nga Caritasi Zviceran dhe nga komuna jonë.

Kemi marrë pjesë në një trajnim të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për Procedurat e Përgjithshme Administrative në Arsim. Dërguam një kërkesë në Masht për lejimin e profileve të mjekësisë në Shkollën e Mesme Profesionale. Pas mbajtjes së Provimit Shtetëror të Maturës, më 26 qershor 2021, më 5 korrik u bë publikimi i rezultateve për maturantët. Sipas rezultateve, reth 58 % të maturantëve kanë arritur pragun e kalueshmërisë. Kemi filluar me procesin e planifikimit të fondit të orëve dhe kuadrit mësimor për vitin e ri shkollor 2021-2022. Është bërë furnizimi me libra për bibliotekat e shkollave. Kemi përgatitur dhe kemi dërguar në MASHT katalogun e teksteve mësimore alternative të propozuara nga Aktivat Profesionale, në mënyrë që të mos kemi vonesa në furnizim.

Është përgatitur Raporti i DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2020-2021, i cili u prezantua në mbledhjen e Kuvendit Komunal. Kemi marrë njoftimin se pas aplikimit që kemi bërë, SHFMU "Gëzim Hamza – Piktori" është përfutuese e projektit "Kidpreneurship – Think. Design. Create." i cili financohet nga Sida-Agjencioni Suedez për Bashkëpunim në Zhvillim Ndërkombëtar e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Nënshkrimi i marrëveshjes u bë më 2 gusht 2021 në Prishtinë. Poashtu, kemi përgatitur dhe kemi dërguar kërkesa në KRU "GJAKOVA" dhe në KEDS për kyçjen në sistemin e ujësjellësit dhe rrymës objektet e çerdheve të reja. Kemi nisur procedurën për projektin "Instalimi i ngrohjes qendrore në SHML "Xhelal Hajda-Toni" dhe kemi bërë gati paramasën e projektit "Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkolla". Kemi filluar me procesin e furnizimit me tekste shkollore për klasat 0-9. Pas furnizimit, këto tekste do t'i shpërndajmë në të gjitha shkollat e komunës sonë.

Ndërkohë, me vendimin e qeverisë, fillimi i vitit të ri shkollor është shtyrë për datën 13 shtator. Është bërë edhe regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta, i vlefshëm për afatin e dytë. U mbajt Provimi Shtetëror i Maturës në dy qendra dhe morën pjesë 170 maturantë. Në oborrin e shkollës në Nagavc janë zhvilluar punimet në ndërtimin e fushës sportive. Në bashkëpunim me QKMF-në organizuam procesin e vaksinimit të punëtorëve të arsimit që nuk kishin marrë dozën e parë. Nga Forca e Sigurisë së Kosovës kemi pranuar dhuratë (donacion) mbi 10000 maska për nxënësit e shkollave të komunës sonë e poashtu jemi furnizuar edhe me 40000 maska të tjera nga Ministria e Arsimit. U mbajt dhe përfundoi trajnimi i grupit të parë të mësimdhënësve të rinjë, ndërkohë që filloi trajnimi me grupin e dytë në Shfmu "Isa Boletini".

Aktivitetet në periudhën tetor – dhjetor

Në shkollën "Gëzim Hamza-Piktori" u përfundua fillimi i zbatimit të projektit "Think.Design. Create", projekt ky i fituar nga komuna jonë. Në objektin e ri të shkollës "Sadëdin Hajda" ka filluar furnizimi dhe pajisja me inventar. Pas lidhjes së kontratës, ka filluar dhe vazhduar procesi i furnizimit me lëndë djegëse (dru për ngrohje) në të gjitha shkollat që përdorin këtë lëndë djegëse. Në shkollat e reja të ndërtuara kanë përfunduar punimet, ndërkohë që punimet përfundimtare u zhvilluan edhe në 3 çerdhet e reja, në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc. Ka filluar të zbatohet projekti i instalimit të kamerave të sigurisë në shkolla dhe është bërë instalimi i tyre në shkollën "Rudolf Ëalther" në Dejnë dhe në paralelen e ndarë në Dobidol. Ka vazhduar të zbatohet projekti i instalimit të kamerave të sigurisë në shkolla, dhe ato u instaluan edhe në objektin e shkollës "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm, në shkollën "31 Marsi" në Guri të Kuq, për të vazhduar edhe në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Drenoc dhe në objektin e paraleles së ndarë në Senoc.

Pas lidhjes së kontratës, ka filluar dhe po vazhdon puna në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e SHML "Xhelal Hajda-Toni". Në objektin e ri të shkollës në Kaznik, është instaluar uji. Është lidhur kontrata në AQP për furnizimin e 4 objekteve të reja shkollore me inventar dhe presim që të bëhet edhe furnizimi. Ka përfunduar procesi i furnizimit me dru të shkollave që përdorin këtë lëndë djegëse.

RAPORTI VJETOR I PUNËS

PËRFUNDIM

Drejtoria Komunale për Arsim gjatë gjithë vitit 2021, ka qenë e përkushtuar në realizimin e planit vjetor të punës, në përcjelljen dhe realizimin e projekteve dhe gjithashtu edhe në përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit edukativo – arsimor në të gjitha nivelet. Përkushtimi ynë do të vazhdojë edhe në gjysmën e dytë të vitit shkollor, gjithnjë në përputhje të plotë me planin vjetor të punës të DKA-së për vitin 2022.



Drejtori i DKA-së

Avni Morina